



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 267, Datë 27.10.2025

MBI

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “FTL” SH.A. LIDHUR ME DETYRIMIN E
ENERGJISË SË RINOVUESHME**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 3, pika 8 dhe 16 të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; Vendimit të bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 284, datë 18.12.2024, “Për miratimin e metodologjisë mbi përcaktimin e detyrimit për energjinë e rinovueshme”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.10.2025, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 2472/1 prot., datë 24.10.2025, të Drejtorisë së Politikave të Burimeve të Rinovueshme, “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “FTL” sh.a., lidhur me detyrimin e energjisë së rinovueshme”,

Konstatoi se:

- Me shkresën nr. 3075 prot., datë 17.09.2025, protokolluar në ERE me nr. 2472 prot., datë 17.09.2025, shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. (FTL) ka paraqitur një kërkesë lidhur me detyrimin e energjisë së rinovueshme,
- Në kërkesën e saj, FTL sh.a. bën me dije se: “Në zbatim të VKM nr. 456, datë 29.06.2022, detyrimi i shërbimit publik për blerjen e energjisë nga burimet e rinovueshme i vendoset shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë, e cila, deri në krijimin e Operatorit të Energjisë së Rinovueshme dhe të tregut likuid të energjisë së ditës në avancë, e përdor këtë energji për mbulimin e humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe për furnizimin në tregun e lirë, ndërsa sasia e tepërt depozitohet në shoqërinë publike të prodhimit për nevojat e furnizimit universal.”
- Gjatë vitit 2025 nuk ka livruar energji elektrike në tregun e organizuar të ditës në avancë dhe/ose brenda së njëjtës ditë dhe si rrjedhojë ndodhet në të njëjtat kushte si në vitin 2025 edhe për vitin 2026, në lidhje me miratimin e detyrimit për energjinë e rinovueshme.
- Në këto kushte, shoqëria FTL sh.a. ka kërkuar vlerësimin e ERE-s lidhur me përcaktimin e detyrimit të energjisë së rinovueshme për vitin 2026.

Në analizë të kësaj kërkesë konstatohet se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 284, datë 18.12.2024, ka miratuar metodologjinë mbi përcaktimin e detyrimit për energjinë e rinovueshme.

- Në dispozitat kalimtare të metodologjisë, konkretisht në nenin 10, parashikohet që, përjashtimisht për vitin 2025, Operatorit të Energjisë së Rinovueshme (OER) ose çdo entiteti që ushtron detyrat e tij, i jepej mundësia të paraqiste kërkesë në ERE për miratimin e detyrimit të energjisë së rinovueshme vetëm nëse ishte përmbushur kushti i përcaktuar në nenin 4.2 të saj, që lidhet me lëvrimin e energjisë së blerë në tregun e organizuar të ditës në avancë dhe/ose brenda ditës. Duke qenë se gjatë vitit 2025 nuk është realizuar lëvrimi i energjisë në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX), shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a., që ushtron detyrat e OER-it sipas VKM nr. 696, datë 13.11.2024, nuk paraqiti kërkesë për miratimin e detyrimit për këtë vit.
- Lidhur me sa më sipër, duke qenë se gjatë vitit 2025 kushti i përcaktuar në nenin 4.2 nuk është përmbushur për shkak të mungesës së lëvrimit të energjisë në tregun e organizuar (ALPEX), shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a., në cilësinë e Operatorit të Energjisë së Rinovueshme (OER), nuk ka paraqitur kërkesë për miratimin e detyrimit për këtë vit dhe rezulton në të njëjtat kushte edhe për vitin 2026.
- Në këto rrethana, vlerësohet se për aplikimin e parë të përcaktimit të detyrimit të energjisë së rinovueshme, OER ose çdo entitet tjetër që ushtron detyrat e tij, do të paraqesë një kërkesë pranë ERE-s pas përmbushjes së kushtit të përcaktuar në nenin 4.2 të metodologjisë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Për aplikimin e parë të përcaktimit të detyrimit të energjisë së rinovueshme, OER apo çdo entitet i cili kryen detyrat e tij, do të paraqesë një kërkesë në ERE mbas plotësimit të kushtit të përcaktuar në nenin 4.2 të metodologjisë mbi përcaktimin e detyrimit për energjinë e rinovueshme.
2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, të njoftojë shoqërinë “FTL” sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Shoqatën Shqiptare të Energjisë së Rinovueshme (AREA), Shoqatën Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) dhe “ALPEX” sh.a. lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI